

STATUTI I SHOQËRISË

“NOKE FRIGUS” SHPK

Në cilësinë e ortakut të vetëm:

Z. FADIL ISUFI, i biri i Nevruz-it, i datëlindjes 09.06.1971 lindur në Tiranë, shtetas shqiptar madhor me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar.

Mbështetur në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Ligjin nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, Ligjin nr. 9723 datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit” në Kodin Civil, Doganor, Fiskal, Tatimor, ortakut i vetëm miraton Statutin e “**NOKE FRIGUS**” SHPK.

Neni 1 **Krijimi**

“NOKE FRIGUS” është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (shpk), person juridik i së drejtës shqiptare, më poshtë e quajtur “Shoqëria”.

Neni 2 **Personaliteti juridik**

Shoqëria fiton personalitetin juridik në datën kur kryhet regjistrimi i saj në QKB, pasi të jetë regjistruar në QKB, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqëria pasi të ketë fituar personalitetin juridik është përgjegjëse ndaj të tretëve për detyrimet dhe dëmet e shkaktuara gjatë veprimtarisë së saj.

Shoqëria “NOKE FRIGUS” Shpk është një e tillë kapital i së cilës është një kuotë e vetme dhe që themelohet nga ortakut i vetëm që përballon humbje vetëm deri në kufirin e vlerës së kontributit të tij në kapitalin themeltar.

Neni 3 **Selia**

Shoqëria e ka selinë në Tiranë, Pezë-Helmes, Zona Kadastrale 2953, Numër Pasurie 6/23.

Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj, të hapë zyra përfaqësie, degë, të krijojë filiale, si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë, vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

Neni 4

Objekti i veprimtarisë

Objekt i veprimtarisë është Import-eksport dhe tregtim me shumicë dhe pakicë i fruta perimeve, bulmetit, djathërave, ullinjve, artikuj industrial, kancelarie, ndërtimi plastike, elektroshtepiake, artikuj ushqimore të të gjithave llojeve, cigareve, pije freskuese, detergjente, konfeksione, veshmbathje të ndryshme, lëndë drusore, mobilje, hapje bar-restorante, hotele, lavazhe, parkingje, prodhimin e verës, rakisë, pije të ndryshme alkoolike dhe jo alkoolike, ndërtimin serave të ndryshme dhe shërbime transporti. Import-eksport tregti me shumicë dhe pakicë të mishit dhe nënprodukteve të tij. Import - eksport dhe tregti me shumicë dhe pakicë të sallamerive të ndryshëm. Import-eksport dhe tregti me shumicë dhe pakicë të brumërave. Import - eksport dhe tregti me shumicë dhe pakicë të vezëve. Import-eksport dhe tregti me shumicë dhe pakicë të agrumeve të ndryshme. Import-eksport dhe tregti me shumicë dhe pakicë të artikujve të konservuar (fruta të konservuara, perime të konservuara, turshi të ndryshme, komposto të ndryshme, mishra të ndryshëm, peshq të ndryshëm etj.). Ruajtje në kushte frigoriferike për vete dhe për subjekte të tjera të artikujve të ndryshëm ushqimore, bulmetra, mishra, sallameri, fruta-perime etj. Import-eksport dhe tregti me shumicë dhe pakicë të verërave të ndryshme, raki dhe pije alkoolike dhe jo alkoolike të të gjitha llojeve. Dhënie me qira të ambienteve të ndryshme.

Neni 5

Kohëzgjatja

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore të papërcaktuar duke filluar nga data e regjistrimit në QKB.

Neni 6

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100'000 (njëqindmijë) lekë dhe është i përberë nga 1,00 (një) kuotë e vetme, vlera nominale e të cilës është 100'000 (njëqindmijë) lekë.

Kapitali i mësipërm është nënshkruar dhe shlyer tërësisht në të holla nga ortakut i vetëm i shoqërisë, z. Fadil Isufi, i cili zotëron kuotën me vlerë të përgjithshme 100'000 (njëqindmijë) lekë, që përben 100% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Kuota e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohet nga letra me vlerë të tregtueshme dhe as kontribute në shërbime.

Ortakut i vetëm përgjigjet për humbjet e shoqërisë përkundrejt të tretëve deri në vlerën e kontributit të tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Neni 7

Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nëpërmjet emërimit nga Asambleja e Përgjithshme (AP) të një eksperti të autorizuar për këto kontribute sipas kërkesës së administratorit/ve.

Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga AP, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.

Në të gjitha rastet zvogëlimi e prek ortakun në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqëson.

Projekti i zvogëlimit të kapitalit u komunikohet ekspertit/ve kontabël të autorizuar, në rast se ka të tillë, të paktën 45 ditë përpara datës së mbledhjes së AP të thirrur për të marrë vendim rreth këtij projekti.

Neni 8 Transferimi i kapitalit

Pjesët e kapitalit themeltar mund t'u transferohen personave të tretë që nuk bëjnë pjesë në shoqëri, vetëm me miratimin e ortakut. Projekti i transferimit i njoftohet shoqërisë dhe ortakut.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie. Ato janë lirisht të transferueshme edhe në rast ndarjeje pasurore mes bashkëshortëve. Gjithashtu janë të transferueshme ndërmjet bashkëshortëve si dhe ndërmjet paraardhësve dhe pasardhësve.

Neni 9 Organi vendimmarrës

Asambleja e Përgjithshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) Përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) Ndryshimet e statutit;
- c) Emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- d) Emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- e) Përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "d" të këtij neni.

Neni 10 Ndryshimet e Statutit

Ndryshimet e statutit vendoset nga Asambleja e Përgjithshme. Çdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKB për të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

Neni 11 Administrimi

Administratori i shoqërisë është ortaku i vetëm z. Fadil Isufi, i biri i Nevruz-it, i datëlindjes 09.06.1971 lindur në Tiranë, shtetas shqiptar madhor me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar. Administratori/rët emërohet/n dhe shkarkohet/n me vendim të AP.

Neni 12 Kompetencat

Administratori/rët ka/në të drejtë e detyrohet të:

- a. Kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë duke zbatuar politikat tregtare të vendosura nga AP;
- b. Përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- c. Kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe librave kontabël të shoqërisë;
- d. Përgatisë dhe të nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, t'i paraqesë këto dokumente përpara AP për miratim.

Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji ua jep shprehimisht ortakëve ai angazhon shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.

Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i administratorit kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rrethanat e dhëna, duke pasur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

Klauzolat e këtij statuti që kufizojnë kompetencat e administratorit, të cilat rrjedhin nga ky nen, duhet të respektohen nga të tretët.

Neni 13 Përgjegjësitë

Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pa miratuara nga AP, që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortaku ka të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit/rëve.

Paditësi ka të drejtë të ndjekë në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërblimin financiar, nëse është e nevojshme.

Ortaku, ka të drejtë në çdo kohë të informohet personalisht për veprimtarinë e shoqërisë dhe të njihet me llogaritë dhe dokumentet e shoqërisë.

Neni 14 Viti financiar

Viti financiar i shoqërisë fillon në 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor. Përjashtimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në QKB dhe mbyllet më 31 Dhjetor.

Neni 15
Bilanci i shoqërisë dhe dividendët

Brenda 6 muajsh nga mbyllja e vitit financiar, mbledhja e AP, miraton bilancin e paraqitur nga Administratori. AP vendos nëqoftëse do të shpërndahet dividendi, në përputhje me politikat ekonomike që ndjek shoqëria për mbarëvajtjen e saj gjatë ushtrimit të aktivitetit tregtar.

Neni 16
Ekspertët

Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomiko-tregtare të shoqërisë, atë gjithëvjetor.

Në përfundim të kontrollit eksperti kontabël i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor të cilin është i detyruar që t'ia paraqesë e dorëzojë në kohë ortakut për t' i shqyrtuar e miratuara mbi bazën e të drejtës vendimore që kanë.

Neni 17
Bilanci kontabël

Bilanci Kontabël vjetor, miratohet mbi bazën e vendimit me shkrim nga ortaku i vetëm i shoqërisë, i cili jo vetëm që dokumenton miratimin e tyre por vendos në lidhje me disponibilitetin e fondeve ligjore sipas nevojave të zhvillimit të mëtejshëm të shoqërisë dhe garantimin e veprimtarisë së rregullt të saj, duke pasur parasysh fondin e akumulimit, krijimin e fondit të veçantë etj.

Neni 18
Përfundimi i shoqërisë

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar priset:

- a. Kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b. Me vendim të AP;
- c. Me hapjen e procedurave të falimentimit;
- d. Nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet edhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë.

Neni 19
Bashkimi dhe ndarja

Shoqëria, me anë të bashkimit, mund t'i kalojë trashëgiminë e saj një shoqërie ekzistuese ose një shoqërie të re që ajo themelon.

Shoqëria gjithashtu me anë të ndarjes mund t'i kalojë trashëgiminë e saj disa shoqërive të tjera ekzistuese ose disa shoqërive të reja.

Ortaku i shoqërisë, që bën kalimin e trashëgimisë së saj në kuadrin e operacioneve të përmendura më lart përfiton pjesë të kapitalit themeltar nga shoqëria ose shoqëritë përfituese

dhe sipas rastit një kompensim me para, vlera e të cilit nuk mund të kalojë 10 % të vlerës nominale të pjesëve të kapitalit themeltar të dhëna.

Operacionet e përmendura më lart mund të realizohen ndërmjet shoqërive të formave të ndryshme.

Bashkimi ose ndarja sjell prishjen pa likuidim të shoqërisë që zhduket, dhe kalimin e plotë të trashëgimisë së saj te shoqëritë përfituese, në gjendjen në të cilën ndodhet kjo trashëgimi në datën e realizimit përfundimtar të operacionit.

Bashkimi ose ndarja sjell njëkohësisht për ortakun/ët e shoqërive që zhduken marrjen e cilësisë së ortakut/ëve të shoqërive përfituese sipas kushteve të përcaktuara në kontratën e bashkimit ose ndarjes.

Neni 20 **Likuidatori**

Afati i emërimit të likuidatorit publikohet sipas kushteve që parashikon ligji përkatës duke specifikuar dhe dokumentet që duhen depozituar ne QKB.

Likuidatori është i detyruar që të jetë i vëmendshëm dhe korrekt, si për realizimin e të drejtave për subjektet ndaj të cilëve shoqëria është kreditore dhe për ekzekutimin e detyrimeve, debive që shoqëria ka ndaj shtetit, shtetasve të veçantë apo personave fizikë apo juridik vendas apo të huaj.

Çdo mosmarrëveshje apo konflikt që mund të lindë gjatë ushtrimit të veprimtarisë së Shoqërisë si rregull dhe përgjithësisht ortakët duhet ta zgjidhin me mirëkuptim, në të kundërtën çështja mund të bëhet objekt konflikti gjyqësor në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor kompetent.

Neni 21 **Konfidencialiteti, ruajtja e sekretit**

Konsiderohen si konfidenciale dhe nuk lejohet të bëhet publike përmbajtja e tyre për të tretët e të gjitha akteve dhe dokumenteve që janë përcaktuar si të tilla nga administratori/rët i/të kësaj shoqërie.

Neni 22 **Baza ligjore**

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.


Neni 23 **Mosmarrëveshjet**

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare.

Neni 24
Dispozita përfundimtare

Ky statut u hartua në katër ekzemplarë me përmbajtje dhe vlera të njëjta juridike dhe pasi miratohet nen për nen nga ortaku i vetëm i shoqërisë tregtare” **NOKE FRIGUS**” Shpk, nënshkruhet në të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmën e tij origjinale.

ORTAKU I VETËM I SHOQËRISË
FADIL ISUFI



Miratuar më datë 10.07.2019.